



Home > LAJME > Kosovë > Tyrezë për financimin e universiteteve publike



## Na gjeni në Facebook

## Marketing

# Tyrezë për financimin e universiteteve publike

November 11, 2014 Ora: 15:01 në Kosovë, LAJME 0 Comments

*Ka filluar tryeza e rrumbullakët "Autonomia dhe llogaridhënia financiare e institucioneve publike të arsimit të lartë në Kosovë", në ndërtesën e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ku u diskutua për sfidat dhe perspektivat e financimit të arsimit të lartë publik në Kosovë.*

Në ditën e parë, u prezantuan mënyrat e financimit të arsimit të lartë (AL) në Kosovë, menaxhimi financiar i institucioneve publike të arsimit të lartë, eksperiencat e partnerëve nga Evropa në lidhje me: autonominë dhe llogaridhënien financiare e institucioneve publike të AL, si dhe modelet e shpërndarjes së buxheteve. Dita e parë u përmbyllet me diskutimin në lidhje me sfidat dhe perspektivat e financimit të arsimit të lartë në Kosovë.

Drejtoresha e Departamentit të Arsimit të Lartë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Drita Kadriu, ka thënë se kjo tryezë ka për qëllim shkëmbimin e përvojave nga universitete të ndryshme të botës.

Kurse, përfaqësuesja e Bashkimit Evropian në Kosovë, Sophie Beaumont, ka thënë se ky projekt është i rëndësishëm për arsimin e lartë, pasi një gjë e tillë, sipas saj, do të sjellë dobi për gjenerimin e të ardhurave në këto institucione arsimore

Kurse në ditën e dytë, dhe të retë do të punohet në një dokument strategjik që do të përmbajë parimet, objektivat dhe indikatorët për krijimin e një sistemi më të avancuar të financimit të arsimit të lartë publik në Kosovë. Në këtë tryezë të ftuar janë edhe përfaqësues nga: Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës, Agjencia e Akreditimit të Kosovës, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", Universiteti "Haxhi Zeka" Pejë, Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka", Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini", Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani", Universiteti FH

CAMPUS ÈIEN (Austri), Universiteti Alikante (Spanjë), Universiteti Sarland (Gjermani), Zyra ERASMUS+ ne Kosovë, ÈUS Kosova dhe institucionet ndërkombëtare që e mbështesin zhvillimin e arsimit të lartë në Kosovë.

Tryeza është organizuar në kuadër të projektit "Ngritja e autonomisë dhe llogaridhënies financiare në institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë", financuar nga Komisioni Evropian, përmes programit TEMPUS.

- Facebook
- Twitter
- Google+
- LinkedIn

### More from my site

Buja: Duke krijuar mësues të mirë, krijojmë të ardhmen	Analistët: PDK e LDK nuk e kanë hallin e qytetarëve	Thaçi e Daçiç do takohen në Vjenë?	Thaçi: Deputetët ta votojnë ligjin për veteranët	Mbështetja e drejtësisë për fëmijë

**Better Deals, More Cashback** **More Fundraising Dollars** [Click here!](#)

« Previous: Sindikata e KEDS-it, kërcënon me grevë

Next: A do të ridizajnohet marrëveshja në Berlin... »

### Komento Ketu

WordPress Google +

### Leave a Reply

Your email address will not be published.

Name

Email

Website

InfoGLOBI | News Agency  
 google.com/+InfoglobiNews  
 News Agency  
 Follow +1  
 + 27

### Galeria

[Shfletu më shumë](#)

### Marketing

**Like Mother, Like Daughter. Like Shopping, Like Cashback**

**Horoskopi Ditor**

### Marketing

Branding & Identity  
 Web Design & Development  
 Design & Publishing  
 Ad campaigns  
 Media strategy  
 Promo & Events